



**ODA
E FARMACISTËVE
TË KOSOVËS**

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Komora Farmaceuta Kosova
Chamber of Pharmacists of Kosovo

Nr.Br.No. 82 Dt. 31.12.19



**ODA
E FARMACISTËVE
TË KOSOVËS**

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOMORA FARMACEUTA KOSOVA

RAPORT I PUNËS

Qershor 2019– Dhjetor 2019

(Prishtinë, Dhjetor 2019)



Përmbajtja

HYRJE	4
1.RAPORTI I PUNËS SË ORGANEVE TË OFK-SË	5
1.1 Këshilli Drejtues	5
1.2 Këshilli Etik	5
1.3 Gjyqi i Nderit	6
1.4 Prokurori	6
1.5. Komisionet e OFK-së	6
1.6.1. Anëtarësimet, Licencimi dhe Rilicencimi.....	6
1.6.2. Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional	10
1.6.3 Komisioni për barnatore komunitare	11
1.6.4 Komisioni për provimin e rilicencimit.....	11
2.PËRFAQËSIMI I OFK-SË NË FIP DHE PGEU	11
2.1. FIP	11
2.2 PGEU	12
3. BASHKPUNIMI ME INSTUCIONE TJERA DHE LOBIMET	12
3.1 Ministria e Shëndetësisë – Lista esenciale e barnave.....	12
3.2 Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	13
3.3. OFK – OMK – OSK – OIK – OFTK.....	14
3.4 Takimi me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës.....	15
3.5 Tryeza Sigurimet Shëndetësore po fillojnë.....	15
3.6 Java kundër korrupsionit	16
3.7 Oda e Farmacistëve të Maqedonisë	16
3.8 Unifikimi i cmimit të barnave.....	17
3.9. Takimi me zyren Ligjore te MAP	19
4 Aktivitetet e EVP-së në bashkorganizim nga OFK	19
4.1 Konferenca “Transformimi dhe Kujdesi Farmaceutik”	19
4.2 Barna të Sigurta dhe Efikase për të gjithë.....	21
4.3 Farmacia e re 2020, Cka presim nga kjo dinamikë.....	21
4.4 Takimet Rajonale me farmacistë	22
5. SFIDAT	23



HYRJE

Të nderuar anëtarë të Kuvendit,

Ky raport paraqet një pasqyrim të punës dhe aktiviteteve të organeve të OFK-së për periudhën raportuese 22 Qershor 2019 – Dhjetor 2019 i cili konsiston në vazhdimësinë e programit për periudhën deri më 21 Qershor 2019 të miratuar në Kuvendin e OFK-së me 29.06.2019



Arianit Jakupi
Kryesues i KQ

Raporti përmban një përshkrim të aktiviteteve dhe shërbimeve të OFK-së gjatë periudhës raportuese

Aktivitetet e paraqitura në raport janë ilustruar me nga një apo më shumë foto representative, dhe të dhënat e ofruar janë paraqitur në diagrame.

Ky format dhe model i raportimit do të shërbejë si standard i raporteve vjetore të OFK-së, në mënyrë që të mundësohet një qasje më e lehtë e krahasimit dhe evaluimit të shërbimeve dhe aktiviteteve të OFK-së prej viti në vit.

Raportet vjetore të punës së OFK-së do të publikohen në Web- faqen e Odës së Farmacistëve të Kosovës, pasi të miratohen nga Kuvendi i OFK-së.

Falenderojmë të gjitha anëtarët e organeve të OFK-së të cilë kanë kontribuar drejt rrugimit dhe sukseseve të përshkruara brenda raportit.

1. RAPORTI I PUNËS SË ORGANEVE TË OFK-SË

Në periudhen raportuese kishte vazhimesi të procesit të punës nga ana e organeve të Odës së Farmacistëve të Kosovës.

Në këtë periudhe takime kanë mbajtur:

1.1 Këshilli Drejtues

Në periudhen raportuese Këshilli Drejtues ka mbajtur 7 takime.

Në këto takime është vendosur

- Caktimin e auditorit për auditimin financiar për vitet 2016, 2017 dhe 2018
- Caktimin e komisionit për provimin e rilicencimit: Arianit Jakupi, Adnan Bozalija, Dashnor Nebiu, Kreshnik Hoti, Valon Ejupi
- Janë dërguar rekomandime në lidhje me projekt UA për organizimin, strukturën, përcaktimin dhe veprimtarinë e institucioneve të kujdesit parësor
- Është vendosur për fillimin e shpërndarjes së faksimilave të farmacistëve
- Janë deleguar përfaqësuesit e OFK-së në FIP dhe PGEU
- Është mbajtur ëorkshop për unifikimin e çmimit të barnave
- Është vendosur për fillimin e lëshimit të ID-kartelave pas miratimit të rregulloreve të reja
- Ëorkshop për ditën botërore të farmacisë.

1.2 Këshilli Etik

Në periudhen 22 Qershor – 9 Dhjetor janë mbajtur 4 takime të Këshillit Etik.

Janë diskutuar kryesisht këto tema që kanë të bëjnë me Këshillin Etik :

- Shqyrtimi i rregullorës së punës.
- Përmirësimi i disa neneve të rregullores së punës nga Këshilli Etik.
- Diskutimi mbi shkeljet Etike në lidhje Mjek-Farmacist-(Kompani e Barnave) për përfitime materiale.
- Mundësia e qasjes të sa më shumë profesionistëve Farmaceutike në Institucionet Shëndetësore publike, siç janë QKMF, QMF si dhe Spitalet Regionale.

1.3 Gjyqi i Nderit

Nga Qershori i vitit 2019 Gjyqi i Nderit ka mbajtur një mbledhje (nëntor 2019) dhe një takim të përbashkët me KD/Këshillin Etik, Prokurorin e Odës.

Gjyqi i nderit ka miratuar Rregulloren finale të Gjyqit të Nderit.

Në takim të përbashkët me KD/Këshillin Etik, Prokurorin e Odës është diskutuar lidhur me rregulloret e të gjitha këtyre organeve të cekura me lartë dhe harmonizimit të tyre.

1.4 Prokurori

Prokurori i Odës së bashku me zv. Prokuroin në periudhën 22 Qershor – Dhjetor ka mbajtur 2 takime në të cilat është finalizuar rregullorja për sa i përket fushëveprimit të Prokurorit të OFK-së. Rregullorja e finalizuar është dërguar në Këshill Drejtues.

Në këtë periudhë është mbajtur edhe takim i përbashkët me Këshillin Drejtues, Këshillin Etik, Gjyqin e Nderit më të cilët janë harmonizuar qëndrimet për sa i përket fushëveprimit të këtyre Organeve.


1.5. Komisionet e OFK-së

Në periudhën raportuese, janë mbajtur takime nga ana e Komisionieve

1.6.1. Anëtarësimet, Licencimi dhe Rilicencimi

Nga periudha e 22 Qershorit deri me 6 Dhjetor të vitit 2019 Komisioni për Licencim ka vazhduar punën ku brenda kesaj periudhe ka mbajtur 14 takime, nga të cilat ka bërë:

- a) Anëtarësimin e 46 farmacistëve të rinj
- b) Licencimin e 32 farmacistëve
- c) Rilicencimin e 32 farmacistëve



Komisioni i Licencimit në periudhen raportuese, pas miratimit të rregulloreve të reja në Kuvendin e Qershorit, ka filluar me lëshimin e licencave me dizjanin e ri dhe përmbajtje të bazës juridike



REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
ODA E FARMACISTËVE TË KOSOVËS
Komora Farmaceuta Kosova
Kosova Chamber of Pharmacists



Në mbështetje të nenet 9, paragrafi 1.3 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nr/04/L-150, nenit 46 të Statutit të OFK-së dhe nent 6, 7 të Rregullorës për Licencimin dhe Rilicencimin e Farmacistëve nr. 39/2019, Oda e Farmacistëve të Kosovës lëshon këtë:

Na osnovu člana 9, paragrafa 1.3, Zakona Komora Adravnih Profesionista br. 04/L-150, člana 46 Statuta Komore Farmaceuta Kosova, člana 6,7 Pravilnika za licenciranje i ponovno licenciranje Farmaceuta br.39/2019, Komora Farmaceuta Kosova izdaje ovu:

In support, the article 9, paragraph 1.3 of the Health Professionals Law nr/04/L-150, article 46 of the Statute of Kosova Chamber of Pharmacists, article 6,7 of the Regulation for Licensing and Relicensing of Pharmacists nr. 39/2019, the Kosova Chamber of Pharmacist issues this:

LICENCË E PUNËS

RADNA DOZVOLA - WORKING LICENCE

Farmacist/Farmaceut/Pharmacist

(Licencim/Licenciranje/ Licensing)

Ue Emër/Kodem- a/Date of Birth: . nr./nr.:


I plotëson kushtet për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur në territorin e Kosovës
Isполняет условия для самостоятельного профессионального деятельности на территории Косовы
Fulfills the conditions for practicing of the profession independently in territory of Kosova.

- Fakulteti i Farmacistë/Farmaceut/Fakultet/Faculty of Pharmacy.
Diploma nr./nr./nr. nr./nr.:
- Data e lëshimit të licencës / Datum isdavanja dozvole/Issuing date of License:
- Data e mbarimit të licencës / Datum isteka dozvole/Expiry date of License:
- Nr. Personal / Libri nr / Personal No:

Kryetar i Komisionit
Predsednik Komisije/Head of the commission

Kryetar i Odës së Farmacistëve të Kosovës
Predsednik Komore Farmaceuta Kosova
President of Kosova Chamber of Pharmacists

Duke u bazuar në rregulloret në fuqi të cilat u aprovuan në Kuvendin e fundit të OFK si dhe me vendimin e këshillit drejtues filloi procedura me pajisjen me vula për specialistët e farmacisë, dhe farmacistët. Deri me 06 Dhjetor janë paraqitur 18 kërkesa për lëshimin e faksimilave.



Ndaj të licencuarve për herë të parë si Specialist, Komisioni për Licencim ka caktuar kodet për përdorim varësisht nga profile

Biokimi Klinike	01
Toksikologji Klinike	02
Teknologji Farmaceutike	03
Hulumtim dhe Kontroll I Barnave	04
Farmacit Klinike	05
Toksikologji e barnave	06
Industri farmaceutike	07

Komisioni i licencimit në bashkpunim me Administratën, dhe Kryetarin e OFK-së, ka filluar testimin e sistemit përmes web faqes së OFK-së për freskimin e të dhënave të anëtarëve në sistem online. Ky sistem pritet që brenda muajit Janar të jetë funksional.

Për dallim nga raporti i muajit Qershor, në këtë periudhë është filluar edhe publikimi i anëtarëve të OFK-së së bashku me datat e skadimit të licencës së tyre. Përditësimi i tyre bëhet në baza mujore në web faqen e OFK-së. Publikimi përmban të gjithë anëtarët e OFK-se pavarësisht nëse ka validitet të licencës.

1.6.2. Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

Në periudhën 23.05.2019 – 11.12.2019 janë mbajtur 11 (njëmbëdhjetë) mbledhje të Komisionit për EVP.

Në këtë periudhë:

1. Janë akredituar 6 aktivitete të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional:

- a) Takimi profesional “Gyn Oncology up to date” – Shoqata e Gjinekologëve të Kosovës (Nr.20/11/06/2019)
- b) Aktiviteti profesional “Transformimi dhe Kujdesi farmaceutik”, i organizuar nga Oda e Farmacistëve të Kosovës. (Nr. 23e-1, datë: 17/06/2019) (Këto janë në raportin e kaluar-pjesa para qershorit)
- c) Takimi profesional ”Dita Ndërkombëtare e farmacistit” - (Nr. 46e-1, datë 24.09.2019)
- d) Konferenca vendore “International Conference on Pharmaceutical and Natural Sciences IC-PNS 2019”, organizuar nga kolegji UBT. (Nr. 48e-1, datë: 23/11/2019)
- e) Konferenca ndërkombëtare OFK “Farmacia e re 2020/ Çka presim nga kjo dinamikë? (Nr. 49e-1, date 23.10.2019)
- f) Kurse pune UFSH OFK AKPPM (Nr. 50e-1, date 23.10.2019)
- g) Kurse online ”Kurset online të formimit në distancë” - Life SHPK – në procedurë
- h) Kurset e trajnimit të organizuara nga AQHP janë akredituar nga KEVP në parim, pala ka refuzuar të paguajë taksën administrative, andaj konform rregullores së KEVP nuk është lëshuar vendimi mbi akreditim.

2. Kërkesa

Është shqyrtuar një kërkesë për përkrahje në aktivitete të EVP dhe e njëjta nuk është miratuar (44e-11.09.2019).

Me 7 nëntor 2019, KEVP i është drejtuar me shkresë KD dhe kryetarit të OFK-së që të japin sqarime lidhur me akreditimin e aktiviteteve online me qëllim të monitorimit të tyre. KD ka marrë vendim që kurset online të mos akreditohen deri në funksionalizimin e ueb faqes së OFK-së në mënyrë që bëhet monitorim i vijueshmërisë së këtyre kurseve

1.6.3 Komisioni për barnatore komunitare

Në periudhën raportuese Komisioni për Barnatore Komunitare ka mbajtur 3 mbledhje të saj në të cilën janë shqyrtuar pyetje për hulumtim AKPPM dhe institucione tjer të cilat kanë të bëjnë me:

- Listën e barnave me Autorizim për Marketing (të gjitha format farmaceutike)
- Listën e barnave me Autorizim për Marketing të importuara në periudhën 2018-2019.
- Cfare masash merr AKPPM ndaj mbajtësve te autorizimi marketingut te cilet nuk importojne barna konform legjislacionit ne fuqi
- Numrin e gjobave të shqiptuara dhe llojet e tyre

Gjithashtu në këto takime janë konstatuar përfundimet nga anketat e realizuar

1.6.4 Komisioni për provimin e rilicencimit

Në periudhën 22 Qershor – 09 Dhjetor 2019 Komisioni për Rilicencim ka mbajtur 3 takime. Në këtë periudhë provimit për rilicencim i janë nënshtruar 11 farmacistë të cilat nuk kanë pasur pikë të mjaftueshme për rilicencim. Të gjithë kanë kaluar në provim.


2. PËRFAQËSIMI I OFK-SË NË FIP DHE PGEU

2.1. FIP



Dy nënkryetarët Dardane Mchaj dhe Gjon Gega u caktuan nga Këshilli Drejtues i OFK-së përfaqësuesi ne Kongresin e Organizuar nga FIP. Gjithashtu në këtë ngjarje kanë marrë pjesë edhe anëtarët e këshillit drejtues Astrit Iljazi dhe Nazif Qazimi të cilët u mbështet financiarisht nga LUX Development. Rëndësia e pjesëmarrjes së OFK në këto takime është pasi duke qenë pjesë aktive e këshillit drejtues të FIP mundësohet qasje në shumë dokumenta strategjike të zhvillimit dhe trendeve të farmacisë botërore. Gjithashtu kjo është edhe një nga ato mundësitë në të cilat merren përvojat e ndryshme të shteteve anëtare të FIP lidhur me politikat farmaceutike, trendet e zhvillimit, përvojat e tyre lidhur me ndryshimet dhe rolin e farmacistëve në këto ngjarje etj.

2.2 PGEU



cilin duhet të ndjekin farmacistët e Kosovës.

Kryetari i OFK-së Arianit Jakupi dhe anëtari i Komisionit për marrënie ndërkombëtare Lutfi Mulaku përfaqësuan OFK-në në mbledhje e asmblesë së PGEU-së. Me këtë rast përveç njoftimit me akterët kryesor të shteteve anëtare gjithashtu u vendosën edhe kontaktet e OFK me këtë organizatë dhe diskutimet lidhur me çështjet e ndryshme në kompetencë të të dy institucioneve.

Si rezultat i këtij takimi edhe u organizua ardhja e kryetarit të PGEU në kongresin vjetor të farmacisë të organizuar nga OFK me një ligjëratë në të cilën u përshkruan të rejtat më të fundit të farmacisë europiane dhe trendi të

3. BASHKPUNIMI ME INSTUCIONE TJERA DHE LOBIMET

3.1 Ministria e Shëndetësisë – Lista esenciale e barnave



Pas një punë intenzive dhe të gjatë mbi një vit u arrit që të aprovohet lista e barnave esenciale ku OFK në këtë grup punues ka qenë e përfaqësuar me kryetarin e saj Arianit Jakupi që ka pasur një rol shumë të rëndësishëm në mbarëvajtjen e tërë procesit.

3.2 Fondi i Sigurimeve Shëndetësore

Më 24.09.2019 është nënshkruar memorandumi i bashkëpunimit me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore. Me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes, Drejtori i Fondit z. Plakiqi e njoftoi për së afërmi Kryetarin e OFK-së z. Jakupi me proceset e realizuara deri më tani dhe për nevojën e marrjes së regjistrimit të farmacistëve të licencuar, që do jenë pjesë e Sistemit Informativ të Fondit. Kryetari i OFK-së u zotua për bashkëpunim të plotë në krijimin dhe azhurnimin e regjistrimit të farmacistëve të licencuar dhe shkëmbimin e këtyre të dhënave me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore, si dhe me ndihmën e plotë të farmacistëve që procesi i sigurimeve shëndetësore dhe reimbursimit të realizohet sa më parë. Sipas memorandumit tanimë Fondi i Sigurimeve Shëndetësore në kohë reale mund të shoh ndryshimet në listën e anëtarëve të OFK-së.



Duke u bazuar në informatat e anëtarëve të Ofruar dhe në bashkëpunim me OFK-në, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore me 21.11.2019 ka filluar trajnimin e të gjithë farmacistëve anëtarë të OFK-së për mënyrën e përdorimit të e-recetës, duke caktuar orarin trajnues sipas regjioneve prej nga jetojnë. Këto trajnime janë bërë për të gjithë farmacistët e interesuar ku sipas regjistrimit final janë trajnuar rreth 950 farmacistë (duke mos kryer këtë procedurë farmacistët që nuk ushtrojnë profesionin në barnatore dhe disa të tjerë që nuk kanë pasur mundësi por për të cilët do të organizohet një sesion i veçantë).

Të gjithë farmacistët që kanë kryer këtë trajnim janë pajisur me certifikata në bazë të të cilave edhe do të mundësohet lidhja e kontratë me fondin (duke qenë kjo një nga parakushtet)



3.3. OFK – OMK – OSK – OIK – OFTK

Odat e profesionistëve shëndetësorë në Kosovë kanë nënshkruar një kontratë të përbashkët, mbi zbatimin e projektit për ndërtimin e objektit, për nevojat e ushtrimit të veprimtarisë dhe funksioneve publike të përcaktuara me Ligj.

Ky objekt i përbashkët i Odave do të jetë i projektuar për të siguruar një sipërfaqe të mjaftueshme për nevojat e tyre.

Ndërtimi i objektit pritet të zbatohet në kuadër të projektit të LUX DEV – Agjencisë për bashkëpunim të Luksemburgut dhe nëpërmjet projektit “Health Support Programme in Kosovo Phase II”.



Kontrata është nënshkruar nga Oda e Mjekëve të Kosovës (OMK), Oda e Infermierëve të Kosovës (OIK), Oda e Stomatologëve të Kosovës (OSK), Oda e Farmacistëve të Kosovës (OFK), Oda e Fizioterapeutëve të Kosovës (OFTK), të gjithë në cilësinë e përfaqësuesve dhe zbatuesve të projektit.

Oda e Farmacistëve të Kosovës në kuadër të projektit do të kontribuojë në shumën prej rreth 17.000 Euro për hapsirën prej 125 metra, dhe shfrytëzimin e hapësirave të përbashkëta.

3.4 Takimi me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës

Me 19 Gusht 2019, është zhvilluar takim i përbashkët mes Kryetarit të OFK-së, anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe Komisionit për Barnatore Komunitare me z. Kadri Veseli – Kryetar i Kuvendit të Kosovës. Në këtë takim njoftuam Kryetari Veseli u njoftua për punën e deritanishëm të OFK-së, dhe problemet me të cilat po ballafaqohen komuniteti i farmacistëve në përgjithësi, duke theksuar problemin e pronësisë së barnatoreve dhe nevojën që kjo të aprovohet në Ligjin për Produkte dhe Pajisje medicinale (pjesa e barnatoreve). Nga ana e z.Veseli u premtua mbështetje institucionale e vazhdueshme në iniciativat e Odave të profesionistëve shëndetësor, me qëllim të përmirësimit të kushteve të punës të profesionistëve shëndetësor që të parandalohet ikja e tyre jashtë vendit.

3.5 Tryeza Sigurimet Shëndetësore po fillojnë

Shoqata e të Drejtave të Pacientëve në Kosovë PRAK, në Ditën e Mbulimit Universal me Shërbime



Shëndetësore, 12 dhjetor, ka zhvilluar tryezën për herë të katërt me radhë "Sigurimet Shëndetësore po fillojnë ?!".

Të pranishëm në tryezë ishin akterë vendimmarrës, deputet të Parlamentit të Kosovës të cilët merren me fushën e shëndetësisë, përfaqësues nga ATK, ATRC, ZKA, shoqëri civile, sindikata, njohës të Sigurimeve Shëndetësore, media dhe shumë akterë të tjerë.

Në këtë tryezë u diskutuan progresi i deritanishëm në implementimin e skemës së

sigurimeve shëndetësore dhe sfidat që mund t'i ketë ky proces. Një konkluzion i përgjithshëm nga kjo tryezë doli se ende nuk janë bërë përgatitjet e duhura që të kemi një fillim të suksesshëm të Skemës së Sigurimeve Shëndetësore pr që është edhe obligim i të gjithë pjesëmarrësve që të marrin përgjegjësitë e tyre institucionale.

3.6 Java kundër korrupsionit

Kryetari i OFK morri pjesë në takimin e organizuar nga rrjeti i organizatave joqeveritare në javën kundër korrupsionit me temë të veçantë për trajtimin e pacientëve jashtë institucioneve publike shëndetësore ku gjithashtu u theksua edhe çështja e barnave specifike. Një pjesë e rëndësishme ishte ajo e theksuar nga kryetari i OFK se barnat kryesore janë të përfshira në kuadër të listës së barnave esenciale kurse pjesa tjetër që mund të jetë e nevojshme do të jetë në kuadër të barnave jashtëspitalore dhe se pacientët mund të përfitojnë në këtë rast vetëm në kuadër të një shërbimi i cili nuk ofrohet në institucione publike dmth shërbimi për të clin mendimi konziliar jepet për institucione tjera do të mund të përfshijë edhe terrapinë e neovjshme.



3.7 Oda e Farmacistëve të Maqedonisë

Kryetari i Odës së Farmacistëve të Kosovës (OFK) Arianit Jakupi së bashku me nënkryetarët Gjon Gega dhe Dardane Mehaj janë pritur në takim nga kryetarja e Odës së Farmacistëve të Maqedonisë (OFM) Bistra Angelovska së bashku me bashkëpunëtorët e saj, kryetarin e kuvendit Imer Imeri dhe Sekretaren Maja Kovaceva.

Në takim u diskutuan çështje të ndryshme të bashkëpunimit në mes të dy institucioneve dhe atyre me interes për komunitetin e farmacistëve. Gjithashtu OFK pret ndihmë duke qenë se Oda e Farmacistëve të Maqedonisë sapo ka festuar 25 vjetorin e themelimit dhe përvoja shumëvjeçare do të jetë ndihmesë për zhvillimin e proceseve të kompetencave të bartura nga MSH por edhe për sektorin Farmaceutik në përgjithësi.

Disa prej temave të diskutimit kishin të bëjnë edhe me provimin dhe procesin e licencimit dhe rilicencimit dhe mënyrën se si ky proces është i organizuar atje, inspektimet për punën profesionale që bëhet në barnatore, gjithashtu edhe për procesin e specializimeve të cilat në Maqedoni janë të ndara në shëndetësore dhe akademike (për të cilat u sqarua se licencimi bëhet vetëm për ato shëndetësore) pastaj edukimin e vazhdueshëm profesional dhe pjesëmarrjen aktive të OFM në grupet punuese të Ministrisë në proceset politikëbërëse të sektorit të farmacisë. OFK është shumë falenderuese për pritjen miqësore dhe gatishmërinë për bashkëpunim duke qenë edhe ne të gatshëm për ndarjen e përvojave tona në këtë sektor.



3.8 Unifikimi i çmimit të barnave

Në këtë punëtori ishte pjesëmarrës edhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, Naim Bardiqi, në cilësinë e kryesuesit të Komisionit për rregullimin e çmimit të barnave si dhe kryetari i Odës së Farmacistëve të Kosovës, Arianit Jakupi, të cilët kanë dhënë shpjegime lidhur me ecurinë se si do të rrjedhë procesi i deklarimit të çmimit të barnave nga subjektet farmaceutike, në funksion të zbatimit të UA Nr. 02/2019 për rregullimin e çmimit të barnave dhe pajisjeve medicinale.

Kryesuesi Bardiqi ka thënë MSh-ja është duke punuar që krejt procesi të jetë transparent, subjektet farmaceutike t'i kenë të qarta përgjegjësitë e tyre dhe hapat për zbatimin e kësaj politike të re në sektorin farmaceutik përmes zbatimit të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2019 dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Në punëtori janë sqaruar hapat dhe detajet që janë të parapara në Udhëzimin Administrativ për proceset që duhet të ndiqen deri në deklarim të çmimit final, pastaj edhe ecuria e punës së Komisionit dhe Bordit të Ankesave deri në finalizim të procesit.



3.9. Takimi me zyrën Ligjore te MAP

Në kordinim me zyrën ligjore të Ministrisë së Administratës Publike, OFK ka hartuar shkresën për ekuivalentimin e pagave të specializantëve dhe specialistëve të farmacisë me kategoritë tjera të profesionistëve shëndetësorë. Shkresa i është dorëzuar instucioneve punëdhënëse të këtyre kategorive të cilët kanë marrë për obligim që shkresën e tillë ta drejtojnë në Ministrinë e Administratës Publike si kërkesë zyrtare të tyre për ekuivalentim të koeficientit të pagave me kategoritë e tjera të profesionistëve shëndetësor.

4 Aktivitetet e EVP-së në bashkorganizim nga OFK

4.1 Konferenca “Transformimi dhe Kujdesi Farmaceutik”

Me 22 Qershor 2019 është mbajtur Konferenca Vendore “ Transformimi dhe Kujdesi Farmaceutik” e orgnizuar nga Oda e Farmacistëve të Kosovës në bashkpunim me Fakultetin e Mjekësisë të niversitetit të Prishtinës, Agjencinë për Produkte dhe Pajisje Medicinale dhe Ministrinë e Shëndetësisë.

Në këtë konferencë të pranishëm ishin të pranishëm mbi 700 pjesëmarrës



4.2 Barna të Sigurta dhe Efikase për të gjithë

Në kuadër të ditës botërore të farmacistit me 25 Shtator 2019 është organizuar aktiviteti “Barna të Sigurta dhe Efikase për të gjithë” ku në fokus të veçantë ishte roli i farmacistit në përmirësimin e njohurive të përdorimit të barnave, minimizimin e interaksioneve dhe efekteve anësore por edhe edukimin shëndetësor. Në këtë aktivitet pjesëmarrës ishin rreth 200 farmacistë.



4.3 Farmacia e re 2020, Cka presim nga kjo dinamikë

Me 2 dhe 3 Nëntor është mbajtur Kongresi I-rë ndërkomtar “Farmacia e re 2020, Cka presim nga kjo dinamikë”. Në këtë aktivitet kishte një pjesëmarrje prej rreth 1000 farmacistëve. Kongresi ishte i ndarë në sesione të ndryshme me tema të veçanta që kanë të bëjnë me Konsumin dhe rezistenca antimikrobike, Farmacinë Klinike, Rregullativën Farmacinë Klinike, Praktika Farmaceutike. Gjatë kongresit është mbajtur edhe ëorkshopi për Inspektimet për GMDP




4.4 Takimet Rajonale me farmacistë

Me datat 26 Nëntor (Gjilan) dhe 9 Nëntor 2019 (Mitrovicë), 13 Dhjetor në Prizren janë mbajtur takime rajonale me farmacistët anëtarë të OFK-së, nga ana e Kryetarit të OFK-së dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues.

Qëllimi i këtyre takimeve ka qenë i karakterit informativ në të cilin kolegët janë njoftuar me aktivitetet të cilat po i bën OFK por gjithashtu edhe me të rejat në sektorin farmaceutik.

Gjithashtu gjatë këtyre takimi u bisedua edhe për problemet aktuale, propozimet për synimet e farmacistëve dhe objektivat të cilat bashkarisht duhet ti avansojmë



5. SFIDAT

- Mekanizmat me efikas për monitorimin e kryerjeve të obligimit për anëtarësim
- Freskimi i të dhënave personale të anëtarëve
- Mungesa e hapësirave për veprim
- Rritja e numrit të farmacistëve të punësuar në sektorin publik
- Zbatimi i legjislacionit për farmaci (puna e plotë e barnatoreve në praninë e farmacistëve)